

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit

MSc në “Mësuesi për Arsimin Fillor”

Ofruar nga Albanian University

Prof.as. dr. Marjana Sinani

Prof.dr. Gëzim Dibra

(Maj- 2017)

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Msc në “Mësuesi për Arsimin Fillor”

Programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi për Arsimin Fillor” mbulohet nga Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Shoqërore në Institucionin e Arsimit të Lartë “Albanian University” dhe është licencuar nga MASH me Urdhër nr.203, datë 8.05.2013. Në vitin akademik 2014-2015 ky program studimi nuk ka pasur student të regjistruar. Studentët e parë në këtë program studimi u regjistruan në vitin akademik 2015-2016 dhe numri i tyre është 8 studentë.

Departamenti i edukimit dhe i Anglishtes mbulon edhe nje program Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor” i akredituar me kusht me **Urdhër Nr.381, datë 08.07.2016**, dhe dy programet Master Profesional në Pedagogji me profile “Didaktikë” dhe “Menaxhim Arsimi” që janë akredituar me **Urdhër Nr.29, datë 31.01.2013**. Referuar Vlerësimit të brendshëm të institucionit dhe statusit të programit në fjalë: Të diplomuarit në këtë program studimi potencialisht ju mundësohet të ushtroni profesionin e tyre mësimdhënës në ciklin e ulët të arsimit fillor. Ata, mund të ushtrohen si specialistë të lartë në administratën shtetërore si ekspertë të fushës si dhe në role drejtuese në institucione publike dhe jo publike. Ndjekja e programit të studimit Master i Shkencave në “Mësuesi për Arsimin Fillor” dhe përfitimi i diplomës në këtë fushë, I ofron mundësi studentëve në vazhdimin e studimeve doktrale.

Organigrama e Institucionit i jep mundësi që të përmbushë qëllimet dhe misionin për të cilin është ngritur.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof.as. dr. Marjana Sinani
2. Prof.dr. Gezim Dibra

Më datë 31.05.2017, me Nr 160 prot, Institucioni ka paraqitur pranë ASCAL përgjigje mbi Draft RVJ.

Grupi I Vlerësimit të jashtëm pasi I lexoi me kujdes përgjigjet e AU, mori në konsideratë vetëm disa prej pikave duke bërë ndryshimin përkatës në RVJ. Ndërsa për pikat e tjera, GVJ jep mendimin e tyre në lidhje me komentet e Institucionit:

Lidhur me pikën e parë: Grupi mendon se jemi shprehur lidhur me prespektivën e ketij masteri dhe nuk ka shprehur se mungon orientimi shkencor në këtë program studimi.

Ligji I ri e vendos taksative për profesionin e mësuesit të fillores ndjekjen e studimeve në master professional dhe jo shkencor. Në master shkencor orientimi duhet të jetë më shumë drejt kërkimit shkencor, duke lejuar studentët që mbarojnë Master professional të vazhdojnë nëse duan Master shkencor duke transferuar kredite sipas rregullores se vetë programit.

Lidhur me pikën dy paqëndrueshmëri stafi: Nga vizita e bërë në fakultet dhe në degën e burimeve njerëzore rezulton se ka pedagogë të cilët janë përfshirë në stafin akademik të programit por që nuk e kanë zhvilluar ato lëndën. Kjo konfirmohet nga syllabuset të cilat nuk korespondojnë në emra pedagogësh. Vetë lista e pedagogëve që mbulojnë lëndët në programin e studimit në RVB në faqe 46;47; **për vitin e parë 2015-16** nuk rezulton se është e saktë. Kështu lënda “Media në mësimdhënien e gjuhës shqipe” aty shkruan se mbulohet nga pedagogu A. Cipa ndërsa në syllabus është Q. Dushku; “Gjuhë e huaj” shkruhet se mbulohet nga G. Taraj, ndërsa në syllabus është B. Kurti; “Metodat dhe materialet në mësimdhënien e matematikës: mbulohet nga E. Hoxha ndërsa në syllabus është S. Rapo; “Drejtim shkolle” mbulohet nga Q. Dushku ndërsa në syllabus është E. Mato; “Sociologji edukimi” mbulohet nga B. Cali ndërsa në syllabus është E. Mato.

Lidhur me literaturën dhe bibliotekën mendojmë se aktualisht kjo është gjendja. GVJ nuk ka shkuar në institucion për të kontrolluar procedurat e realizimit të procedurave financiare për sigurimin e literaturës por si është gjendja aktuale. Numri I librave për këtë program studimi është shumë I reduktuar, ska student të regjistruar nga ky program studimi.

Lidhur me financimin e kërkimit shkencor: GVJ mendon se aktualisht kjo është gjendja. Ne nuk kemi shkuar për të kontrolluar procedurat e sigurimit të financave për kërkimin shkencor por si është gjendja aktuale: Asnje lek I planifikuar në buxhet (faqe 34 RVB).

Lidhur me pikën për planin mësimor në llogaritjen e ngarkesave dhe krediteve: GVJ nuk mendon se është lapsus I departamentit por konkluzioni ynë është se ka një mungesë serioziteti ose mosnjohje në percaktimin e krediteve në perputhje me orët totale që duhet të ketë një lëndë për studentin ose që miratimi në department I planit mësimor është formal.

Lidhur me pikën për programin e studimit si format: GVJ nuk ka theksuar se nuk janë këto elemente në raportin e vlerësimit apo edhe në rregullore, por mendojmë se një program studimi sipas shtojcës së Udhezimit Nr 14 i MASH datë 03.04.2008 I ka të gjithë këto elemente pavarësisht se janë apo nuk janë në rregullore apo në raport. Elementet janë: 1.Emertimi; 2. Vendimi I organeve përgjegjëse; 3. Objektivat formuese dhe karakteristikat e programit (a,b,c); 4. Struktura akademike përgjegjëse dhe strukturat ndihmese; 5. Kuadri I përgjithshëm formues I programit; 6. Personeli akademik që realizon programin. 7. **Plani mesimor.** 8. Programet e studimit që mundësojnë pranimit në programin e studimit. 9. Infrastruktura në dispozicion të programit. 10. Kriteret specifike të pranimit të studenteve. 11. Tarifa. 12. Financime të tjera. Tek ju është vetem **plani mesimor** ose nuk është paraqitur programi me të gjithë elementët.

Lidhur me raportin mes lëndëve Bachelor dhe Master: GVJ mendon se në tërësinë e programit janë 8 lëndë që janë në dy programet ose meqense janë disa lëndë me zgjedhje mund të zbrisin deri në 5 lëndë. Në totalin prej 16 lëndësh të programit Master kjo shifër prej 5 lëndësh ose 8 nuk është e pakonsiderueshme, pavaresisht se cfarë njohurish jepen. Të paktën të ishte ndryshuar emërtimi I tyre.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit Msc. në “Mësuesi për Arsimin Fillor” ka si mision: Përgatitjen e specialistëve të lartë për mësimdhënie në ciklin e ulët, për drejtues të institucioneve dhe organizmave të edukimit si dhe për të kryer studime të avancuara në fushën e edukimit dhe administrimit të tij.

Objektivat e këtij programi studimi synojnë të përgatisin mësimdhënës në ciklin e ulët të arsimit fillor, specialistë të lartë të administratës shtetërore, ekspertë të fushës si dhe në role drejtuese në pozicione publike dhe jo publike; mundësi për vazhdimin e studimeve doktorate. Këto objektiva synohen të arrihen nëpërmjet veprimtarive akademike të formimit të përgjithshëm, të formimit karakterizues, dhe aftësimit praktik. Studentët që do të ndjekin këtë program studimi parashikohet t’i realizojnë këto veprimtari gjatë dy viteve akademike kundrejt një sasive prej 120 kreditesh ECTS.

Në një kuadër të përgjithshëm objektivat dhe qëllimet e këtij programi studimi synojnë të përshtatin kurrikulën dhe metodologjinë, si të mësimdhënies dhe të formimit specifik të studentit, në mënyrë të tillë që të bëhet e mundur përshtatja e mësuesit të kërkuar me ndryshimet shoqërore dhe ekonomike të vendit, duke nxjerrë nga ky program studimi, studentë që të kenë mundësi të kryejnë detyra të ndryshme në kuadrin shoqëror

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit; Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit; Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Konfirmojmë që: Programi “Master shkencor Mësues në Arsimin Fillor” është ndërtuar në përmbushje të qëllimit dhe misionit të institucionit. Konfirmojmë që: Programi “Master shkencor Mësues në Arsimin Fillor” bazuar në misionin dhe objektivat e tij ishte në përmbushje të nevojave të tregut të punës në kohën kur është licensuar, por ky

	<p><i>tregues me Ligjin e ri të Arsimit të Lartë 80/2015 për nivelin e dytë të studimeve në Arsimin Fillor është zbehur.</i></p> <p>Konfirmojmë që: Programi “Master shkencor Mësues në Arsimin Fillor” orientohet nga tendencat e zhvillimit ekonomik të vendit që reflektohet relativisht në kurrikulën e programit të studimit dhe programet e lëndëve përkatëse, formuluar nga institucioni në kapitullin “Qellimet dhe Objektivat”</p> <p>Rezulton që: “Master shkencor Mësues në Arsimin Fillor” <i>dëshmojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit dhe përmbushin ambicien e institucionit.</i></p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	<p>Programi i studimit i ciklit të dytë “Master i shkencave në Mësuesi për Arsimin Fillor” është përshtatur në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional.</p> <p>Programi i studimit është përshtatur me kriteret e përcaktuara në strategjinë e institucionit, veçanërisht me pikën 2, “Mësimdhënia, kurrikula, mësimnxënia”.</p>
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Rezulton që: Programi i studimit i ciklit të dytë “Master i shkencave në Mësuesi për Arsimin Fillor” është në përputhje dhe konform me ligjin e Arsimit e Lartë, aktet nënligjore, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit.</p> <p>Konfirmojmë që emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</p>
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Rezulton se Institucioni ka në vëmendjen e tij përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për cilësi gjithnjë e më të lartë të këtij programi.</p> <p>Rezulton se Institucioni ka hartuar një plan strategjik për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të nxënit duke synuar kombinimin e nivelin teorik të programit me atë praktik, duke futur teknologjitë e reja të mësimin dhe të nxënit, duke shtuar motivimin për kërkim shkencor. Institucioni ka një plan strategjik për sa i përket zhvillimit të tij, i cili është i vlefshëm për një periudhë 5 vjeçare dhe përmban të gjitha drejtimet e studimeve që ofron.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Konfirmojmë se përmbajtja e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Mësuesi për Arsimin Fillor” është nëpërputhje me kriteret e përcaktuara nga Ligji nr.9741 “Për Arsimin e Lartë në Shqipëri” (indryshuar) dhe aktet nënligjore në fuqi, si udhëzimet, në mbështetje të tij. Programi i studimit i ciklit të dytë Master i shkencave në “Mësuesi për Arsimin Fillor” është përshtatur në përputhje me strategjinë e zhvillimit institucional. Ky program studimi në kohën kur është hartuar ishte në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk binte ndesh me interesat kombëtare. <i>Sot në kushtet e reja të krijuara pas daljes së Ligjit të ri Arsimit të Lartë mendojmë se Masteri i Shkencave në “Mësuesi për Arsimin Fillor”</i></p>	

duhet të orientohet për të kryer studime/kërkime të avancuara në fushën e edukimit dhe administrimit të tij. Ky program studimi synon që nepërmjet formimit shkencor të studentëve të krijojë baza të qëndrueshme njohurish për të vazhduar më pas me studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve.

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Fakulteti "Shkencat Shoqërore" është një nga tre fakultetet e IAL Albanian University. Fakulteti ka në përbërjen e tij 4 departamente Fakulteti ofron programe të studimeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme në përfundim të të cilave përfitohet diplomë sipas ciklit përkatës. Fakulteti përbëhet nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë mësimore - shkencore dhe nga administrata.

Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes është një nga 4 departamentet e këtij fakulteti. Departamenti mbulon programet e studimit te nivelit bachelor, master profesional dhe master shkencor si edhe është "Masteri shkencor ne Arsimin Fillor"

Të dhëna të përgjithshme për organizimin e AU, bëhen publike dhe në website, dhe manifestet e ndryshme që Universiteti publikon çdo fillim viti akademik. Baza e të dhënave si dhe e stafëve akademike dhe administratës së Universitetit ndodhet e dokumentuar dhe rifreskohet çdo fillim viti akademik nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila funksionon si hallkë ndërlidhëse midis Fakulteteve, Departamenteve dhe të gjitha njësiteve të tjera bazë që funksionojnë në Universitet sipas Statusit dhe Rregullores së Institucionit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit

Fakulteti i Shkencave Shoqërore është një nga njësitë e IAL Albanian University që organizon dhe drejton mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Fakulteti ofron programe të studimeve të nivelit të parë bachelor, dhe të dytë Master Profesional dhe Shkencor në përfundim të të cilave përfitohet diplomë sipas ciklit përkatës. Autoritetet drejtuese janë Dekani, Zëvendës Dekani, Përgjegjësit e departamenteve dhe Drejtuesi i Qendrës kërkimore. Organ drejtues është Këshilli i Fakultetit. Aparati administrativ i Fakultetit përbëhet nga Sekretaria mësimore dhe nga personeli ndihmës. Struktura organizative, përbërja, funksionimi dhe të tjera çështje që lidhen me të janë të përcaktuara në rregulloren e fakultetit.

Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti ka 4 departamente Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes, Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme, Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative dhe Departamentin e Shkencave Juridike. *Numri i stafit akademik efektiv në Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes aktualisht është: 14 pedagog efektiv (2 Prof. Asoc.; 9 Dr.; 2 Doktorante në Proc. dhe 1 Msc.). Ndërkohë që numri i stafit akademik me kontratë është 18 (1 Prof. Dr.; 1. Profesor akademik, 4 Prof. Asoc.; 4 Dr.; 3 Dr. Proc dhe 5 Msc). Numri i pedagogëve ka ndryshuar gjatë periudhës 2 vjecare të studimit të këtij masteri për arsye largimesh të pedagogëve apo kalimesh nga pedagog me kontratë në pedagog efektiv.*

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij; Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete; Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	AU organizohet në mënyrë që të bëjë sa më efektiv arritjen e misionit bazë të tij, mësimdhënies, dhe arritjen e objektivave bazë të paraqitura në Statut dhe Rregulloren e tij. Konfirmojmë që Albanian University ka në përbërjen e tij 3 Fakultete, Fakulteti i shkencave Shoqërore në të cilin bën pjesë edhe Departamenti i Edukimit dhe

<p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Anglishtes, Fakultetin e Shkencave Mjekësore si edhe Fakultetin e shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike.</p> <p>Konfirmojmë që Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka në përbërje të tij këto njësi bazë: Departamentin e Edukimit dhe</p> <p>Anglishtes, Departamentin e Psikologjisë së Përgjithshme, Departamentin i Shkencave Politiko-Administrative dhe Departamentin e Shkencave Juridike.</p> <p>Rezulton se të gjitha njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, operojnë me nga një rregullore të veçantë, në të cilat përcaktohen objektivat dhe misionet.</p> <p>Rezulton se Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, ka një staf akademik që i plotëson kriteret e vendosura në Ligjin mbi</p> <p>Arsimin e Lartë. <i>Numri i stafit akademik efektiv në Departamentin e Edukimit dhe Anglishtes ka ndryshuar nga largimet apo edhe kalimet nga pedagog me kontratë në efektiv. Aktualisht janë 14 pedagog efektiv (2 Prof. Asoc; 9 Dr.; 2 Doktorante në Proc. dhe 1 Msc.). Ndërkohë që numri i stafit akademik me kontratë është 18 (1 Prof. Dr.; 1. Profesor akademik, 4 Prof. Asoc.; 4 Dr.; 3 Dr. Proc dhe 5 Msc)</i></p>
---	---

Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Rezulton që: njësitë bazë dhe stafi akademik që mbulon programin e studimit janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë në lidhje me realizimin e programeve që ofrojnë, konkretisht të programit të studimit “Master Shkencor Në Mësuesi në Arsimin Fillor”. Ata përcjellin standarte në punën e tyre duke ndikuar në realizimin e misionit, objektivave dhe mbi të gjitha realizimin e një mësimdhënieje cilësore dhe bashkëkohore.</p> <p>Rezulton që: Njësitë bazë përfshihen në rekrutimin e personelit akademik të nevojshëm, sipa procedurave të përcaktuara në rregulloren e institucionit dhe të njësisë, duke insistuar në formimin akademik adekuat të pedagogëve të cilët pritet të përmbushin cilësisht programin.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Konfirmojmë se programi i studimit Master i Shkencave në “Mësuesi për Arsimin Fillor” është në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe se egziston një strukturë e brendshme funksionale që bën të mundur të përmbushë qëllimet e misionit të institucionit konform ligjit. *Njësite bazë të institucionit qoftë ato administrative dhe ato akademike e kerkuese, bashkeveprojnë në funksion të rritjes se cilësisë, rekrutimit të stafit dhe promovimit të cilësisë midis stafit.*

Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes, ka një staf akademik që i plotëson kriteret e vendosura nga Ligji mbi Arsimin e Lartë *Numri i pedagogëve në departament ka ndryshuar gjatë periudhës 2 vjecare të studimit të këtij masteri për arsye largimesh të pedagogëve, apo kalimesh nga pedagog me kontratë në pedagog efektiv.*

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Stafi akademik i institucionit është organizuar në dy struktura: Stafi në funksion të përmbushjes së programeve bachelor, stafi në përmbushje të studimeve në nivel Master. Stafi në përmbushje të studimeve “Master në Mësuesi në arsimin Fillor” përbëhet prej 6 pedagogë {PAE}: 2-prof.as.; 4-Dr; dhe 7 pedagogë PAK 1 Prof.akademik; 2 Prof.as; 3 Dr, dhe 1 Dr në proces. Konfirmoj që janë 8 studentë të rregjistruar në Programin “Master në Mesuesi

në arsimin Fillor” në vitin 2015 - 2016. Personeli administrativ është 7 dhe është si në shërbim të programit master ashtu edhe të institucionit në tërësi. Shpërndarja e ngarkesës rezulton pranë normës së lejuar. Rekrutimi bëhet konform rregullave të brendshëm të institucionit të cilat derivojnë nga ligji për arsimin e lartë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit
- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori/ët e programit të studimit
Nuk ka këshill shkencor, drejtues i Masterit është Drejtori i Departamentit
- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (plotëso Tabelën 4)
Rezultoni se stafi që jep mësim në programin Master si ai efektiv dhe ai me kontratë është me tituj dhe grada shkencore. Ajo që mund të thuhet për stafin është paqëndrueshmëria, largime apo edhe kalime të lëndëve nga një pedagog në tjetrin.
- Të dhënat sipas seksit
Rezultoni se nga i gjithë stafi akademik (PAE & PAK) dhe ai administrativ raporti sipas seksit në programin e studimit është 5 femra dhe 5 meshkuj, ndërsa në shkallë departamenti stafi (PAE&PAK) është 22 femra dhe 9 meshkuj
- Të dhëna sipas moshës së personelit
Në përgjithsi stafi akademik efektiv (PAE) ka një moshë të re dhe i ndarë sipas grupimit 25-45 vjeç janë 10 vetë staf akademik dhe 7 staf administrativ dhe sipas grupimit 45-65 janë vetëm 5 vetë staf akademik. Ndërsa stafi akademik me kontratë (PAK) grupimi 25-45 janë 15 vetë dhe grupimi 45 -65 janë 13 vetë. Të dhënat janë për të gjithë stafin e departamentit për vitin 2015-2016.
- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat
Konfirmojmë se të gjithë antarët e stafit akademik dhe administrativ janë me kontratë të rregullt pune me afat të caktuar ose pa afat.
- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë
Stafi ndihmës, **rezultoni se është i përgatitur dhe punon me seriozitet.**
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
Lista e pedagogëve të departamentit dhe të stafit të angazhuar për programin e studimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre; Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Konfirmojmë që: personeli akademik dhe administrativ i institucionit angazhohet seriozisht në përmbushje të qëllimeve të programit dhe të strategjisë së institucionit.

<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Konstatohet që: Personeli akademik qoftë PAE dhe PAK, angazhohet sistematikisht në hartimin e kurrikulës, dhe ndjek rrugën institucionale për miratimin e saj. Rekrutimi i stafit bëhet konform ligjeve që rregullojnë raportet kontraktuale të stafit me institucionin dhe ngarkesa mësimore rezulton të jetë e mirërregulluar.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Konstatohet që: Institucioni ndjek procedura ligjore transparente për rekrutim të stafit PAE dhe PAK dhe në institucion gjenden të gjitha kontratat e nënshkuara me anëtarët e stafit akademik në mënyrë të përditësuar.</p> <p>Konfirmojmë se personeli akademik efektiv në departamentin e Edukimit dhe Anglishtes që mbulon programin e studimit Master në Mësuesi për Arsimin Fillor përbën 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e këtij programi</p> <p>Konfirmojmë që: institucioni reflekton seriozitet, vijshmëri të dokumentuar vlerësimin periodik të personelit. (www.albanianuniversity.edu.al) është adresa elektronike ku shpallen vendet për konkurim të stafit PAE dhe PAK</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Konstatojmë që: Përgjegjësi i Programit gëzon titullin Prof.As.Dr. fituar në Universitetin e Tiranës.</p> <p>Konfirmojmë që: Cdo titular i lëndës në programin në fjalë gëzon minimalisht titullin Dr. dhe përvojë punë më shumë se 5 vjet.</p> <p>Konfirmojmë që: Rektori, zv/rektori, dekani, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve në fjalë.</p> <p>Konfirmojmë që: Institucioni, garanton udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve përgjatë procesit të praktikave profesionale si dhe përgjatë procesit të hartimit të tezave të tyre në nivel Master.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Konfirmojmë që: Në programin e studimit në fjalë ndjekin studimet 8 studentë. Institucioni ka siguruar që për çdo student të ketë një udhëheqës në punën kërkimore për përgatitjen e tezës deri në përfundim të ciklit të studimit. Cdo pedagog që udhëheq studentin gëzon minimalisht gradën Dr.</p> <p>Konfirmojmë që: Një pedagog udhëheq një student. Ka vetëm një pedagog që udhëheq dy studentë. Kjo për faktin e një numri të reduktuar studentësh të përfshirë në këtë program studimi.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Konfirmojmë që: Udhëheqësit e studentëve përgjatë tezës, gëzojnë ekspertizë adequate në raport me temën e zgjellur nga studenti.</p> <p>Konfirmojmë që: Pedagogët zoterojnë mjaftueshëm formimin teorik dhe eksperiencat për të çuar studentët deri në përmbyllje të tezave të studimit.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Konfirmojmë që: Institucioni angazhohet dhe vë në dispozicion laboratorët dhe infrastrukturën teknologjike për përgatitjen e tezave dhe të detyrave përgjatë arritjes së qëllimeve dhe objektivave të programit. {sjell si fakt dy punime mediatike të kryera nga studentët në këtë program duke përdorur laboratorët teknologjikë të institucionit}</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Konfirmojmë që: Ngarkesa mësimore është e detajuar në orë mësimore për çdo pjesëtar të stafit PAE dhe PAK, kjo konform akteve në fuqi dhe është e rregulluar dhe sanksionuar në kontratën individuale të secilit.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Konfirmojmë që: Egziston një bazë të dhënash të detajuar për stafin akademik të angazhuar në programin e studimit. Per secilin semestër, ka lista të mirëcaktuara të stafit dhe të detyrave respektive. Institucioni publikon kriteret për procedurat e rekrutimit të stafit dhe ndjek ato me korrektesë.</p>

Konkluzionet e vlerësimit: Titullarët e institucionit duke filluar nga, Rektori, zv/rektori, dekani, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve në fjalë. Personeli akademik qoftë PAE dhe PAK, angazhohet sistematikisht në hartimin e kurrikulës së programit në fjalë, dhe ka ndjekur rrugën institucionale për miratimin e saj. Institucioni publikon kriteret për procedurat e rekrutimit të stafit dhe ndjek ato me korrektesë. Udhëheqësit e studentëve përgjatë tezës, gëzojnë ekspertizë adeguate në raport me temat e zgjedhura. Institucioni angazhohet dhe vë në dispozicion laboratorët dhe infrastrukturën teknologjike për përgatitjen e tezave dhe të detyrave përgjatë arritjes së qëllimeve dhe objektivave të programit.

4. **Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Pjesa përshkrimore

Institucioni përmbush programin në fjalë në hapësira dhe mjedise fizike të mjaftueshme. Mjediset fizike janë në hapësira të shëndetëshme duke ju referuar numrit të reduktuar që ndjekin programin. Teknologjitë e informacionit, si laboratorit i kompjuterave me programe specifike është në funksion të studentëve. Biblioteka në tituj fizikë në fushën e edukimit si dhe biblioteka on-line potencojnë punën e studentëve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin e Fakultetit: Sasia - Sip.

Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	2 zyra	85 m. katror
Zyra për sekretarinë mësimore	4 zyra	83m. katror
Zyra për departamentet/qendrat kërkimore	9 zyra	270 m. katror
Zyrë për financën	2 zyra	47 m. katror
Zyrë për Njësinë e SBC	1 zyre	23.2 m. katror
Salla për mbledhje	1 zyre	34 m. katror
Nyje higjeno-sanitare	2 mjedise	27.3m. katror
Mjedise shërbimi teknik	2 mjedise	6 m. katror

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nuk është marrë ndonjë dokumentacion

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Konfirmojmë që: Institucioni ka vendndodhje të përhershme, ku gjenden mjedise fizike në të cilat përmbushen nevoja administrative, logjistike, dhe mësimore.</p> <p>Mjediset fizike dhe Godina e institucionit është në pronësi të pronarit dhe garanton përmbushjen e programit për më shumë se 6 vjet. Programi përmbush qëllimet dhe objektivat e veta brenda të njëjtës godine, cka krijon lehtësi për përmbushjen e programit.</p> <p>Konfirmojmë që: Institucioni garanton mjedise dhe kapacitetet e nevojshme për përmbushje të praktikave profesionale në programin në fjalë.</p>
<p>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Konstatojmë që: Titujt e literaturës në funksion të përmbushjes së këtij programi të thedhur janë relativisht të reduktuar. Mungojnë tituj botimesh të “identifikuar” dhe të konfirmuar qëllimshëm në funksion të programit.</p> <p>Rezulton që: Titujt e librave në bibliotekën e institucionit janë siguruar në rrugë vullnetare, dhe egzistojnë relativisht në numër të reduktuar kopjesh</p> <p>Rezulton që: Institucioni nuk ka ende politika të mirëfillta financiare në funksion të burimeve literale. Në zyrën e financës, nuk egziston një document-blerjeje nga institucioni i titujve me përfaqësues në fushat akademike mbi të cilin funksionon program në fjalë.</p> <p>Konfirmojmë që: Lista e literaturës së paraqitur zyrtarisht nga institucioni pothuajse egziston.</p> <p>Konfirmojmë që: Fondi në bibliotekë është i përbashkët për të gjitha programet në shkencat e edukimit. Biblioteka punon në orar të plotë dhe mundëson studentët. Nga kontakti me punonjësen e bibliotekës rezulton që nga 380 studentë në gjithë programet e edukimit, vetëm 14 prej tyre kanë celur kartelë në bibliotekën e institucionit, ndërsa nga 8 studentët që vazhdojnë studime të thelluara në programin Master Shkencor nuk rezulton I regjistruar asnjë.</p> <p>Konstatojmë që: Stafi brendshëm profesional orienton studentët drejtë literatures që duhet dhe mund të përdorin. Egziston një bibliotekë on-line “Questia” ku studentët marrin kontakte.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p>	<p>Dëshmojmë që: Kemi vizituar mjediset fizike ku përmbushen qëllimet e programit në fjalë dhe se egziston një laborator teknologjik si dhe një atelie e cila shërben për të gjitha programet në edukim, përfshi edhe programin e masterit shkencor në Arsimin Fillor.</p> <p>Konstatojmë që: Mjediset mësimore janë të përshtatshme dhe të mirëmbajtura për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit.</p>

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Konkluzionet e vlerësimit: Institucioni ka vendndodhje të përherëshme në Bulevardin Zogu i Parë, ku gjenden mjedise fizike në të cilat përmbushen mjaftueshmërisht, nevoja administrative, logjistike, dhe mësimore të programit në fjalë.

Mjediset fizike dhe Godina e mirendodhur, garanton përmbushjen e programit për më shumë se 6 vjet. Programi përmbush qëllimet dhe objektivat e veta brenda të njëjtës godine, cka krijon lehtësi për përmbushjen e programit. Mjediset fizike janë në hapësira të mjaftueshme duke ju referuar numrit të reduktuar {8 studentë} që ndjekin programin. *Titujt e literaturës në funksion të përmbushjes së këtij programi të thedhuar, janë relativisht të reduktuar. Institucioni nuk ka ende politika të mirëfillta financiare në funksion të burimeve literale. Në zyrën e financës, nuk egziston një document-blerjeje nga institucioni i titujve me përfaqësues në fushat akademike mbi të cilin funksionon programi në fjalë. Nga të dhënat e bibliotekës figurojnë vetëm, 14 studentë të regjistruar në kartelat e bibliotekës, nga 380 gjithsej, dhe asnjë student i regjistruar nga program Master Shkencor në Arsimin Fillor*

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Burimet financiare të programit në fjalë, vijnë mësëshumti, nga tarifat e shkollimit, të cilat, shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin të stafit dhe e strukturave që lehtësojnë programin. Në nivel institucioni, ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare, dhe kontrollin dhe rigjenerimin e tyre. Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm. Në raport gjenden të dhëna për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative, etj. Bazuar mbi kriteret e standardeve shtetërore të cilësisë ky Institucion ia ka dalë që të mbulojë me kosto financiare të gjitha shërbimet e kërkuara. Kostot operative vjetore ndryshojnë nga njeri program studimi tek tjetri, për shkak të veçorive që ka secili prej tyre. Burimet financiare janë ato që lidhen me tarifat e shkollimit të studentëve. Rreth 1/3 e burimeve të të ardhurave shpenzohet për qiranë e objektit dhe shërbime të tjera të lidhura me të (mirëmbajtja, pastrimi, ngrohja, ftohja etj). Pjesa tjetër e burimeve të të ardhurave shpenzohet për pagesën dhe sigurimet e punonjësve të brendshëm si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamën, internetin, pajisjet e aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit.

Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen periodikisht

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Emërtimi i treguesve financiare	Në -%
Fondi i pagave (a+b)	0.61%
Për kontribute sig.shoqërore	0.09%
Për kontribute sig.shëndetsore	0.10%
Honorar për mësim dhënie	0.11%
Për kancelari	0.02%
Për veprimtari shkencore	0.00%
Fondi ekselencës	0.13%

- Grantet për kërkim – 0.00%
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit – 1500 Euro në vit akademik për një student
- Sponsorizimet – nuk rezultojnë të ketë

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Nuk ka të dhëna

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Nuk disponojmë dokumentacion specifik të marrë nga institucioni.

Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet dhe të ardhurat (duke iu referuar bilancit)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Rezultoni se ka një raport financiar dhe auditimi vjetor i cili realizohet nga ekspertë të jashtëm. Bazuar mbi kriteret e standardeve shtetërore të cilësisë ky Institucion ia ka dalë me sukses që të mbulojë me kosto financiare të gjitha shërbimet e kërkuara. Raport auditimi për programin e studimit të veçantë nuk ka, pasi bëhet për të gjithë institucionin.</p> <p>Konstatohet se raporti financiar dhe të auditit paraqiten të gjitha detyrimet dhe të ardhurat (duke iu referuar bilancit).</p> <p>Konstatohet se në raportin financiar vjetor dhe të auditit theksohet se aktualisht universiteti nuk përfiton asnjë grant të huaj që përfitohen nga kontratat e shërbimeve.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Rezultoni se Institucioni nuk ka një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programit të studimit "Mater I Shkencave Mësuesi në Arsimin Fillor", si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj, pasi kjo realizohet në total për të gjithë institucionin.</p> <p>Rezultoni se Institucioni ka një qëndrueshmëri financiare dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen, për të siguruar qëndrueshmërin e programit të studimit "Mater I Shkencave Mësuesi në Arsimin Fillor".</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>Konstatohet se IAL "Albanian University" ka një organizim dhe mbajtje të rregullt të të dhënave financiare të institucionit. Dokumentacioni i lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet është i rregullt dhe dëshmohet edhe nga rezultatet e kontrolleve periodikë të cilave u është nënshtruar institucioni. Është pozitiv fakti që niveli i të ardhurave është konstant, gjë që tregon për një stabilitet në vazhdimësi të aktivitetit akademik dhe shkencor të universitetit. <i>Ajo që të bie në sy është fakti se në buxhetin e këtij institucioni nuk ka të parashikuar asnjë lekë për zërin "Kërkimi Shkencor" qoftë për mbështetje të pedagogëve për të marrë pjesë në konferenca apo veprimtari shkencore, apo edhe për shpenzime të tjera që lidhen me aktivitetin e "Qendrës së Kërkimit Shkencor" pranë këtij institucioni si njësi kryesore universitare e cila merret me studime, kërkime shkencore, të aplikuar dhe fundamentale.</i></p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

ZSBC ndonse deklarohet që është e përbërë nga një grup pune prej katër individësh e përkatësisht: Dr. Proc. Elona Mehmeti, Dr. Desara Agaj, Msc. Sidita Çoniku dhe Msc. Klotilda Dauti rezultoni se përbëhet

nga 2 persona. Kjo zyrë harton politikat e vetëvlerësimit dhe përcakton dhe kriteret e vlerësimit që do të ndiqen, bën hartimin e anketimeve dhe modeleve të raporteve vlerësuese, dhe pas plotësimit të tyre prej studentëve apo pedagogëve, ZSBC bën përpunimin e të dhënave dhe nxjerr problematikat kryesore.

Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, parashikohet nga neni 18 i Statutit të Universitetit, si një organ i pavarur, i cili ka akses në të gjitha informacionet e Universitetit. Kjo zyrë është në varësi të drejtpërdrejtë të Rektorit të Universitetit, dhe paraqet një raport vjetor në të cilin përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar, si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrevë të cilësisë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët.
Me studentët bëhen dy vlerësime në vit sipas semestrave.
- Sa studentë janë anketuar
– në rastin e Master shkencor në Arsimin Fillor rezultoni të jene anketuar të gjithë {8} pergjigjur janë vetëm 5 vetë) Duhet theksuar se në anketim janë përfshirë lëndët që janë bërë sipas planit mësimor të tre semestrave (përgjigjet janë vetëm për lëndët: Vlerësim shkolle; Menaxhim klase; MKSH; Teoritë dhe ideologjitë e edukimit; Njohuri të kompjuterit.
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
– nuk ka probleme specifike të identifikuar nga studentët.
- Kontrolli i brendshëm i cilësisë
– funksionon dhe njih mirë rolet e NJSBC
- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike
- relativisht
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
– Një fotokopje të një model pyetsori me rezultate.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në</p>	<p>Konstatohet që: Institucioni përdor në mënyrë periodike forma vlerësimi që lidhen me ecurinë e programit. Format dhe instrumentet e vlerësimit inicohen nga Zyra e sigurimit të cilësisë, përpunohen dhe marrin feedback prej studentëve. Kjo Zyre insiston në vlerësimin e dy anshëm, nga vetë stafi dhe nga studentët njëkohësisht. Stafi është i detyruar të vetëvlerësojë punën cdo tre muaj.</p> <p>Konstatohet që: Institucioni aplikon metodologji vlerësimi të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për të bërë vlerësimin. Metodatat më të aplikuara janë sondazhet të studentëve dhe pyetje konceptuale.</p>

<p>vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>Konfirmojmë që: Zyra e sigurimit të cilësise merr në konsideratë për vlerësimin e cilësise së programit, rezultatet e studentëve, testimet, provimet, punët e pavaruara, pjesëmarrjen në auditor, mardhëniet e studentit me biblioteken dhe literaturën, e tjer.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Konstatojmë që: Nuk kemi asnjë botim, broshurë, të hartuar enkas nga Institucioni për këtë qëllim në këtë program. Konstatojmë që ky format vlerësimi është rutinë, pra bëhet por nuk ka botime enkas.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Konstatojmë që: Institucioni zhvillon analizë vjetore për ecurinë e programeve të studimit, por nuk dëshmojmë se duke ju referuar vlerësimeve që kanë dalë, të ketë pasur ri-formatim apo ndryshime deri në 10-15% të programit në fjalë, {Master shkencor për Arsimin Fillor} në emër të përmirësimit të cilësisë.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Konstatohet që: <i>Institucioni ndonjëherë ka programe të akredituara këtë vit është në proces akreditimi institucional.</i></p> <p>Konstatohet që: Departamenti ndjek procedura periodike për sigurimin e standardeve dhe cilësisë, por, relativisht nuk përdor, mekanizma formalë, për të bërë mbikëqyrjen e vazhduar të programit në fjalë. Gjatë takimeve vetë stafi konfirmoi që nuk ka asnjë ndryshim të programit që nga viti 2013 kur është licensuar</p> <p>Konstatohet që: institucioni njih rëndësinë vlerën dhe dobinë e programit.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Institucioni përdor në mënyrë periodike forma vlerësimi që lidhen me ecurinë e programit. Format dhe instrumentet e vlerësimit inicohen nga Zyra e sigurimit të cilësisë, përpunohen dhe marrin feedback prej studentëve. Kjo Zyra insiston në vlerësimin e dy anshëm, nga vetë stafi dhe nga Studentët njëkohësisht. Stafi është i detyruar të vetëvlerësojë punën cdo tre muaj. Zyra e sigurimit të cilësisë merr në konsideratë, rezultatet e studentëve, testimet, provimet, punët e pavaruara, pjesëmarrjen në auditor, mardhëniet e studentit me bibliotekën dhe literaturën, e tjer. Nuk ka rezultatet e vlerësimit të botuara në trajtë broshure. Ka analizë vjetore për vlerësimin por nuk ka feedback, {nuk ka ri-formatim të programit që nga viti 2013.</p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkimore

Programi Master shkencor në Arsimin Fillor është i akredituar në vitin 2013 dhe ka filluar përmbushjen e tij në vitin akademik 2015-2016 dhe vazhdim. Konfirmohet se është i organizuar në module dhe kredite sipas sistemit evropian të transferimit të ECTS. Kohzgjatja është 2 vite dhe studenti fiton 120 ECTS. Ka një rregullore të studimeve ku janë pasqyruar objektivat e programit, struktura dhe elementët e tij. Plani mësimor është ndarë në disiplina me kredite përkatëse. Ka një ndarje kredite për leksion dhe kredite për seminare, orë në auditor dhe orë punë e pavarur e studenteve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit të Master shkencor për Arsimin Fillor
ka filluar në: 2015-2016, Viti i dytë, 2016 – 2017, është në vazhdim.
- Organizimi i programit të studimit (2 – vite akademike, 4 - semestra, 30 javë etj.)
 - 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
 - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
 - 1 javë mësimore 20 orë mësimore në auditor
 - ECTS sipas semestrave janë, për vitin e parë nga 30 ECTS, dhe për vitin e dytë 28 dhe 32 ECTS.

Duhet theksuar se në programin e studimit të paraqitur gjatë vizitës nuk ka element të tjerë si objektivat formuese të programit, disipinat formues me kredite përkatëse, personelin akademik, kriteret e pranimit

të studenteve, strukturën akademike përgjegjëse që duhet të ketë një program bazuar në udhëzimin 14 MASH datë 03.04,2008, ndonëse këto element janë pasqyruar dhe trajtuar në raportin e vlerësimit të brëndëshëm të institucionit.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

▪ Për leksionet	645 orë në auditor dhe	905 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Seminaret	285 orë në auditor dhe	395 orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Labororet	____ orë në auditor dhe	____ orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikat lëndore	____ orë në auditor dhe	____ orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikën Profesionale	10 orë në auditor dhe	30 orë punë e pavarur e studentit
▪ Provimi përfundimtar	260 orë në auditor dhe	500 orë punë e pavarur e studentit

Në llogaritjen e ECTS në planin mësimor sipas disiplinave shpesh ka mospërputhje të numrit të orëve me pikë kreditet ose nëse krahasojmë ngarkesën në orë dhe kredite në planin mësimor krahasuar me ngarkesën në syllabuset e paraqitura, gjen mospërputhje.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Nuk ka ndryshime në Planin mësimor, krahasuar me programin mësimor të licensuar

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 7)

Mbulohen me pedagogë me tituj dhe grada shkencore. Duhet theksuar se ka lëvizje të pedagogëve dhe shpesh nuk ka përputhshmeri mes pedagogut që bën syllabusin me atë që e jep.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Hartimi i syllabuseve është standart dhe është bërë konform elementëve që janë përcaktuar në rregulloren e institucionit dhe që janë pasqyruar në raport.

Në planin mësimor kemi verejtur se:

1. Metodologji e përgjithëshme e mësimdhënies: 45-15-60 orë; 90 ore pune pavarur (e jep Qazim Dushku) (bëhet edhe ne Bachelor)
2. Psikologji edukimi: 45-15-60 orë {Prof.Dr Erleta Mato}; 90 ore pune pavarur (behet edhe ne Bachelor)
3. Metodadat dhe materialet e mësimdhënies së matematikës: 45-15 ;90 ore pune pavarur (Prof.As.Dr. Elida Hoxha) (e jep Sotir Rapo)
4. Media në mësimdhënien e gjuhës shqipe: 45 – 15 – 60 orë ;90 ore pune pavarur (Prof.As.Dr. Qazim Dushku) (e jep A. Cipa)
5. Shkrimi dhe publikimi akademik: 30-15- 45; 75 ore pune pavarur {Prof. Akademik. Gjovalin Shkurtaj}
6. Gjuha angleze: 30 – 15 - 45 orë (Bledar Kurti) përgatiti syllabusin G. Taraj behet ne bachelor
7. Organizimi dhe drejtimi i shkollës: 45 – 30 –75 ;125 ore pune pavarur {Prof.Dr. Erleta Mato} (e jep Qazim Dushku)
8. Sociologji edukimi: 45 – 15 60; 90 ore pune pavarur orë {Prof. Dr.Erleta Mato} e jep B. Cali.

9. Metodatat dhe materialet e mësimdhënjes së diturisë së natyrës 45-15-;90 ore pune pavarur {Dr. Mariola Kodra}
10. Media në mësimdhënjen e leximit letrar: 45 – 15; 90 ore pune pavarur {Prof.As.Dr. Qazim Dushku}
11. Drejtëshkrimi i gjuhës shqipe: 30-15-; 75 ore pune pavarur {Dr. Ardian Tana} *Behet edhe ne bachelor*

Në planin mësimor kemi verejtur se:

1. Kërkimi shkencor në edukim: 30-15- 55 orë punë e pavarur e studentit {Dr. Ndrim Mehmeti}
2. Teoritë dhe ideologjitë e Edukimit: 30 – 15 – 55 orë punë e pavarur e studentit {Dr. Elona Doko}
3. Vlerësimi i shkollës dhe mësimnxënies 45 – 30 – 100 punë e pavarur e studentit {Prof.Dr. Bedri Kola}
4. Njohuri Kompjuteri për fëmijë: 30-15-55 orë punë e pavarur e studentit { Prof. As.Dr. Arjana Bejleri}
5. Menaxhim Klase: 45 – 30 – 100 orë punë e pavarur e studentit {Prof.Dr. Bedri Kola} *behët edhe ne bachelor*

Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

– kemi marrë vetëm fotokopje të rregjistrit themelor të lëndëve të regjistruara nga titullarët e lëndëve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Konfirmojmë që: Programi “Master shkencor në Mësuesi për Arsimin Fillor” është i licensuar në vitin 2013 dhe ka filluar përmbushjen e tij/programit në vitin akademik 2015-2016 dhe vazhdim. Konfirmojmë se është i organizuar në module dhe kredite sipas sistemit european të transferimit të ECTS. Kohëzgjatja është 2 vite dhe studenti fiton 120 ECTS.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me</p>	<p>Rezulton se “Master shkencor në Mësuesi për Arsimin Fillor” ju adresohet të diplomuarve që zotërojnë diplomën “Bachelor” dhe bazuar në objektivat e tij synon përgatitjen e menaxherëve dhe specialistëve të shkollës; me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional, përgatitjen e specialistëve të lartë për mësimdhënie në arsimin fillor, si dhe për të kryer studime të avancuara në fushën e edukimit dhe administrimit të tij.</p> <p>Rezulton se: “Programi “Master shkencor në Mësuesi për Arsimin Fillor” për kohën kur është hapur i ka shërbyer përgatitjes së mësimdhënësve si profesion dhe ka patur objektiva të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm të mësuesve të arsimit fillor në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ndryshimet në Ligjin e ri të Arsimit të lartë janë reflektuar edhe në mos rregjistrimet e studentëve në këtë program për vitin 2016-2017</p>

<p>sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Konstatohet se përmbajtja, objektivat e programit të studimit “Master shkencor në Mësuesi për Arsimin Fillor” realizojnë në përgjithësi dhënien e njohurive në nivelin e studimeve që ofron. Duke marrë në konsideratë mënyrën e konceptimit të përmbajtjes së disa lëndëve si njohuri të zgjeruara mbi nivelin bachelor, mendojmë se numri i tyre në raport me tërë planin mësimor duhet të jetë më i drejtë.</p> <p>Rezultoni se metodot e vlerësimit të studentëve si në kontrollin e vazhdueshëm ashtu edhe në testimin përfundimtar janë në përputhje me nivelin e studimit të programit në fjalë.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disaveçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Rezultoni se Programi i studimit “Master shkencor në Mësuesi për Arsimin Fillor” mbështetet në përvojën disa vjeçare të funksionimit të vetë AU-së, si dhe në marrëveshjet e lidhura të universitetit me disa universitete ndërkombëtare siç janë Corvinus i Budapestit në Hungari, IPUS-it në Zvicër, etj.</p> <p>Konstatohet se Programi i studimit “Master shkencor në Mësuesi për Arsimin Fillor” në objektivat, strukturën, përmbajtjen, kriteret format dhe metodat e vlerësimit është përgjithësisht në përputhje me udhezimet e MAS, objektivat dhe legjislacionin e BE për tu bërë ndërkombëtarisht e konkurrueshme.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p>	<p>Konstatohet se Programi i studimit “Master shkencor në Mësuesi për Arsimin Fillor” në objektivat e tij të programit ka përcaktuar si formimin profesional ashtu edhe shkencor të studenteve. Në realizimin tërësor të këtyre objektivave ka vend për përmirësim si në tërësinë e lëndëve që jepen në raport me nivelin bachelor ashtu edhe formave më të spikatura për realizimin e kërkimit shkencor të studentëve</p>

<p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Konstatohet se stafi akademik i departamentit dhe ai i programit të studimit janë përfshirë dhe angazhohen në punën kërkimore shkencore për realizimin e këtij programi.</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaja.</p>	<p>Konfirmohet që: <i>Institucioni ka bërë një studim për të identifikuar nevojat e tregut për programin në fjalë, por kërkimi, na rezulton që të jete holistik dhe të mos ketë identifikuar specifikisht nevojën për studime të thelluara në këtë nivel shkollimi {arsimin fillor}</i></p> <p>Konfirmohet që: <i>Programi studimit në fjalë të ketë qartësisht argumente për nevojën e tregut, por studentët e regjistruar në këtë program, nuk e përligjin arsyen për të cilin ky program është ndërtuar.</i></p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Konstatohet që: Studentët e përfitues të programit janë numerikisht pak, janë të punësuar jo në sektorë strategjikë të arsimit, ku seriozisht, studimet në këtë nivel të dytë studimesh të thelluara të potencojë ata{studentët} në përmirësim të cilësisë së tregut të punës.</p> <p>Konstatohet që: <i>Institucioni nuk ka parashikime për ecurinë e mëtejme të këtij programi, sa është i rritur interesi për rregjistrime të reja për vitin e ri akademik që pritet të vijë.</i></p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Konstatohet që: Programi i studimit në fjalë është në rezonancë të plotë me interesat kombëtare dhe ruan e konservon vlerat kulturore kombëtare.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezen që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Konstatohet se Kohëzgjatja normale e programit të studimit Master i Shkencave në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, është 2 vite akademike. Përkatësisht në fund të ciklit të studimit, studenti përfiton 120 kredite evropiane, të cilat respektivisht ndahen në 60 ECTS vitin e parë akademik, 30 ECTS vitin e dytë akademik dhe 30 ECTS nga punimi i Tezës së Diplomës</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Nuk kanë qënë objekt i vlerësimit tonë.</p>


<p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>Nuk kanë qënë objekt i vlerësimit tonë.</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Dëshmojmë që: Dija universitare në programin në fjalë është tërësisht e përtypëshme nga studentët dhe se modulet, ofrohen nga stafi akademik në forma të larmishme, të shkruara, të parashtruara me gojë në forma leksioni, si dhe në trajtë elektronike.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Konfirmojmë që: Institucioni ka planifikuar procesin dhe moduset e diplomimit të studentëve brenda afatit të parashikuar. Konfirmojmë që cdo student i përfshirë në këtë program është i angazhuar në përmbushjen e tezes në fundvitit dhe diplomimit, e cila merr 30- ECTS.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se IAL Albanian University ofron programe studimi të licencuara sipas legjislacionit në fuqi. Në kuadrin e kësaj është edhe Programi MSc në “Mësuesi për Arsimin Fillor” i organizuar në përputhje me udhëzimet e MAS me një shtrirje 2 vjet studime me 120 ECTS. Ngarkesa vjetore është 60 kredite, e ndarë mes dy semestrave nga 30 ECTS për vitin e parë, dhe 28 dhe 32 për vitin e dytë. Rregullorja e studimeve për programin Master përmban të detajuar strukturën objektivat, misionin, kompetencat, rregulla për provën finale, diplomimin dhe marrjen e dokumentit të diplomës, element të cilët duhet të ishin detajuar edhe në programin e studimit sipas udhëzimit nr 14 date 03.04.2008 të MASH. Programi i studimit I paraqituri përmban vetëm planin mësimor. Rezultoni se plani mësimor është në përputhje me misionin dhe objektivat e institucionit dhe ligjin e arsimit të lartë, por mendojmë se ka ndonjë mospërputhje lidhur me ngarkesat në auditor punë individuale të studentëve dhe ECTS përkatëse. Stafi që e mbështet këtë program është me tituj dhe grada shkencore sipas kërkesave të ligjit të arsimit të lartë, por duhet të këtë qëndryeshmëri pasi ka largime të stafit që shprehen në mospërputhjen e pedagogut që bën syllabusin me atë që e zhvillon mësimin. Programi i studimit ofron kualifikim profesional dhe shkencor të studentëve në përputhje me tregun e punës, por mendojmë se raporti mes njohurive që ofron ky program dhe programit bachelor duhet të përmisohet, kushtëzuar kjo edhe nga ligji i ri nr. 80/2015 i Arsimit të Lartë dhe kërkimin shkencor që kushtëzon për licensim të mësuesve vetëm marrjen e masterit profesional nga ana e studentëve. Ky program studimi ruan vlerat kulturore kombëtare, dhe është përgjithësisht në përputhje me udhëzimet e MAS, objektivat dhe legjislacionin e BE për tu bërë ndërkombëtarisht e konkurueshme.</p>	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Procesi i mësimdhënjes respekton intresat specifike dhe përvojat individuale të studentëve. Format e mësimdhënies janë ndërvepruese, kontrolli i njohurive të studentëve bëhet në të gjitha rrugët e mundshme. Në varësi të specifikës së lëndëve të caktuara pedagogët operojnë dhe me teknologjitë e mësimdhënies. Pedagogët, tregojnë fleksibilitet për të ofruar mbështetjen e tyre në varësi të kërkesave individuale që secili student kërkon.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies:

- Leksione - po
- Seminare - po
- Laboratore
- Praktikë lëndore - po
- Praktikë profesionale - po

Format e kontrollit të njohurive – të larmishme, teste, bashkëbisedime, provim, detyra kursi

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë

- Po. Një studente, përfituese e programit në fjalë, është anëtare e RVB.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Procedurat e pranimit të studentëve zhvillohen konform ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit. Cilësia në hyrje e studentëve, në programin në fjalë është pothuaj nën mesatare, gjë që, nuk e potencon qëllimin për të cilin bëhet shkollimi I thelluar në nivelin e dytë. Numri i studentëve të regjistruar janë {8 studente}, të gjitha të seksit femër. Të gjitha studentet e regjistruara në program janë të punësuar në institucione të arsimit fillor, respektivisht në qytetet Tiranë, Skrapar, Peshkopi.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve
 - egziston dokumentacioni i plotë për secilin student të regjistruar.
- Cilësia në hyrje e studentëve
 - në nivelin nën mesatare
- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë).
Nota Mesatare mbi notën - 6
- Studentë të diplomuar në vitin e fundit
 - ende nuk ka studentë të diplomuar. Janë në vitin e dytë.
- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend.
Dy studentë vinë nga Vitrinat, një nga Universiteti i Vlorës, 5 studentë nga AU.
- Të dhëna për punësimin e studentëve
 - Të gjitha në institucione të arsimit fillor.
- Numri total i të punësuarve
(në përputhje me diplomën)
- Numri total i të punësuarve
(jo në përputhje me diplomën)
- etj

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Konfirmojmë që: Të 8-studentët e regjistruar në programin në fjalë zotërojnë diplomat Bachelor, vetëm njëra prej tyre ka një diplomim ekstra në master shkencor në UT por për nevoja të ruajtjes së punësimit po ndjek studimet në këtë program.</p> <p>Pranimi dhe regjistrimi i studentëve është bërë conform ligjit dhe rregullores së institucionit. Studentët e regjistruar në programin në fjalë nuk e kanë shlyer detyrimin e gjuhës angleze që kërkon ligji, por janë të përfshirë në mësimin e gjuhës angleze. Kjo e justifikon dhe fakti që në program është e përfshirë dhe mësimi i gjuhës angleze.</p> <p>Konstatojmë që: Institucioni është në procesin e përpunimit të politikave të reja të pranimit të studentëve.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Konstatuam që: studentët kishin mjaftueshëm informacion rreth mundësive të punësimit pas përfundimit të programit dhe diplomimit. Studentët kishin informacion rreth shërbimit që ofron institucioni për këshillimin e metejmë të karrierës</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Dëshmojmë që: institucioni dispononte statistika të sistemuara dhe dokumentuara për studentët që ishin të regjistruar në programin në fjalë. Nuk rezultojnë student që janë tërhequr nga program i studimit në fjalë. Kishte të dokumentuara gjithë frekuentimin e studentëve në lëndët e zhvilluara aktualisht dhe rezultatet e secilit.</p> <p><i>Rezulton se 2 studentë ishin jo të paisur me numër matrikullimi</i></p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Konfirmojmë që: Institucioni kishte të dhëna në system për secilin student. 7 nga studentët që ndjekin programin në fjalë, janë të punësuar, përjashtojnë njëra prej studentëve e cila ishte e papunësuar për shkak objektiv.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Dëshmojmë që: Studentët e njihnin statusin e programit që ndjekin, por, nuk ishin mjaftueshëm në gjëndje të bënin diferencën mes programeve master profesional dhe master shkencor.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillim e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Konstatuam që: Institucioni ishte i mirëinformuar për ecurinë dhe vështirësitë e secilit student dhe ofronte mundësi kontaktesh individuale me secilin prej tyre jashtë programit të konfirmuar. Studentët i përmbushnin praktikën profesionale në institucionet respective. Nuk na u ofrua një program i institucionit për praktikën profesionale si pjesë e programit të studimit.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Të 8-studentët e regjistruar, zotërojnë diplomat Bachelor, vetëm njëra prej tyre ka një diplomim ekstra në master shkencor në UT, por për nevoja të ruajtjes së punësimit po ndjek studimet në këtë program. Pranimi dhe regjistrimi i studentëve është berë konform ligjit dhe rregullores së institucionit. Institucioni ishte i mirëinformuar për ecurinë dhe vështirësitë e secilit student. Studentët i përmbushnin praktikën profesionale në institucionet respective. Nuk na u ofrua një program i institucionit, enkas, për praktikën profesionale si pjesë e programit të studimit. Nuk rezultojnë studente që janë tërhequr nga program i studimit në fjalë. Janë të dokumentuara gjithë frekuentimin e studentëve në lëndët e zhvilluara deri aktualisht dhe rezultatet e secilit. Studentët kishin mjaftueshëm informacion rreth mundësive të punësimit pas përfundimit të programit dhe diplomimit.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Kërkimi shkencor në IAL Albanian University është pjesë e rëndësishme e misionit dhe objektivave të tij dhe është, në funksion të politikës tërësore të universitetit dhe të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit. Veprimtaria kërkimore – shkencore e AU priret, organizohet e zhvillohet në zbatim të ligjit nr.9741, dt. 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” duke u përqendruar kryesisht në realizimin e kërkimit shkencor e të aplikuar studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese sipas objektivave specifike të institucionit; krijimit të një raporti të drejtpeshuar dhe efektiv ndërmjet mësimdhënies e kërkimit shkencor; në përfshirjen e studentëve në grupet studimore e projekte që ka departamenti, fakulteteti ose universiteti. Në kuadrin e punës shkencore Fakulteti i Shkencave Shoqërore gjatë vitit 2015-16 ka organizuar konferencën studentore me titull: “Sfidat e Arsimin të Lartë në Republikën e Shqipërisë në Funksion të Integritimit në Bashkimin Evropian” një seminar me temë “Metodat e reja të mësimdhënies dhe mësimnxënies me në qendër nxënësin” dhe ka nxjerrë një gazetë të studentëve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor

Ka një përfshirje të stafit në punën shkencore dhe kualifikimin shkencor nepërmjet pjesmarrjes në aktivitete shkencore si konferenca, botime në revista shkencore dhe një përfshirje edhe e studentëve në këto veprimtari. Flitet për një strategji kërkimi shkencor që miratohet nga Senati por që nuk pasqyrohet në dokumentacionin që ka Fakulteti apo departamenti. Nuk ka plan vjetor individual apo shkallë departamenti për kërkimin shkencor.

- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Është paraqitur një raport individual i realizimit të veprimtarisë shkencore të stafit akademik në pesë vitet e fundit, ku bie në sy pjesmarrje e gjërë e tërë stafit. Për vitin 2015-2016 numri i botimeve është 15 botime.

Numri i projekteve kërkimore të fituara - nuk ka

- Numri i projekteve të zbatuara – nuk ka

- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

Në raport përmenden disa aktivitete shkencore ku bie në sy një konference shkencore, dhe botimi i revistës shkencore periodike OPTIME. Numri total i veprimtarive për 2015-2016 është 3.

- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL – {8}

- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor- *thuhet se janë 3.*

- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

Jepet një numër 5 studentë por nuk është e dokumentuar}

- Numri i Çmimeve Kombëtare- *nuk ka*

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse; Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Konfirmojmë se personeli akademik ka publikime artikujsh shkencor apo pjesmarrje në konferencat e organizuara nga vetë institucioni ose në konferenca të organizuara nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. IAL Albanian University publikon revistën periodike “Optime“, e cila përmban shkrime shkencore të pedagogëve të institucionit, por edhe shkrime të studiuesve jashtë AU nga Kosova, Maqedonia, Italia, Kanadaja, etj. Konfirmojmë se stafi akademik jep një kontribut konkret në zhvillimin e shkencës së edukimit nëpërmjet angazhimeve në veprimtarinë shkencore si dhe me botime tekstesh universitare, e më gjërë.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Konfirmojmë se IAL Albanian University nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj, por ka ofruar lëndë dhe leksione të veçanta në gjuhë të huaj në Programet MSc dhe MP.</p>
<p>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtjshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Rezulton se sipas raportit të vlerësimit të brëndëshëm, institucioni organizon programe të brëndëshme kualifikimi profesional me stafin e tij drejtuar nga pedagogë të stafit të tij dhe të tjerë të jashtëm me përvojë në mësimdhënie, <i>por ne nuk na është prezantuar ndonjë evidencë lidhur me këtë veprimtari.</i></p> <p>Rezulton se institucioni ndonëse ka planifikuar një veprimtari kualifikuese në ndihmë të stafit akademik nuk ka parashikuar asnjë lek në buxhetin e tij.</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Rezulton se institucioni disponon një raport individual të tërë pedagogëve për punën shkencore dhe botimet e cila është pasqyruar në anekset e raportit por nuk rezulton se ka një bazë të dhënash lidhur me studimet shkencore të personelit.</p> <p>Konfirmojmë se institucioni nuk ka asnjë projekt shkencor ku stafi akademik merr pjesë.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Konfirmojmë se ka një përfshirje të stafit në punën shkencore dhe kualifikimin shkencor nepërmjet pjesëmarrjes në aktivitete shkencore si konferenca, botime në revista shkencore dhe një përfshirje edhe e studentëve në këto veprimtari. Institucioni ka një strukturë efektive e cila përbëhet prej Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe departamentet/Fakultetet. Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor formulon dhe orienton politikën e zhvillimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore në vijimësi; bashkërendon dhe koordinon punën kërkimore të fakulteteve dhe të departamenteve. Ka një Komision për Kërkimin Shkencor dhe Botimi i Revistës “Optime”</p> <p>Mendojmë se kjo veprimtari shkencore duhet të programohet në strategjinë për kërkimin shkencor, që nuk rezulton se është, dhe të mbështetet edhe me planifikim në buxhetin e institucionit pasi për zërin kërkimor nuk ka planifikim. Rezulton se nuk ka ndonjë projekt kërkimor të përfshirë apo të zbatuar nga institucioni dhe numri i konferencave apo aktiviteteve shkencore është I kufizuar vetëm 3</p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

IAL. Albanian University ka të përcaktuar prioritetet e politikës së tij të bashkëpunimit me institucione locale kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat janë të lidhura me strategjinë afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të institucionit dhe merr në konsideratë nevojat e ekonomisë vendase dhe të tregut të punës. IAL “AU” ka marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe të arsimit të lartë, struktura shtetërore dhe private jashtë institucionit, apo edhe pedagogë të huaj që kanë lidhje me Programin e Studimit

të ciklit të dytë: Në këtë kuadër Albanian University ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e studimeve të Palermos; Universitetin e Pizës, dhe e Laquillas Itali; Universitetin e Corvenus ne Hungari.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
 - Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare nuk ka
 - Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj
deklarohet 3 pedagog por nuk ka evidencë
 - Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit 6 pedagog
 - Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL ska
 - Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor
 - Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime
Stafi akademik që mbulon programin e studimit ka një pjesmarrje të kënaqshme në aktivitete shkencore brënda dhe jasht vëndit
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
 - Institucionet qeveritare bashkëpunuese
Ka një bashkëpunim me institucionet qeveritare që lidhen me arsimin si Drejtoritë Rajonale të Arsimit dhe institucione të tjera.
 - Organizatat Profesionale
ka marrëveshje bashkëpunimi me OJF
 - Komuniteti i biznesit, tregu i punës

Dokumentacioni përkatës

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Konfirmojmë se institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me Drejtoritë Rajonale Arsimore në shumë rrethe të vendit si dhe me struktura të tjera shtetërore dhe OJF të cilat i mundësojnë studentët të realizojnë praktikën mësimore dhe të përfitojnë njohuri profesionale.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Rezulton se ka një bashkëpunim ndërdepartamental bazuar në angazhimin e ndërsjellët të pedagogëve duke siguruar përmbushjen e procesit mësimor në lëndë të ndryshme nga specialistë të mirëfilltë në fushat përkatëse dhe ka rritur mundësitë e shkëmbimit të eksperiencave të pedagogëve.</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Konfirmojmë se Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj</p> <p>Konfirmojmë se Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione si Drejtoritë Rajonale Arsimore në rrethe apo struktura të tjera qendra dhe organizata profesionale cilat I mundësojnë studentët të realizojnë praktikën mësimore.</p> <p>Rezulton se Departamenti realizon një raport analitik në kuadër të përfitimeve nga marrëveshjet e realizuara me institucione arsimore, duke përcaktuar nivelin e aftësisimit të studentëve dhe shkallën e vënies në praktikë të njohurive teorike të përfutuara.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Grupi i vlerësimit të jashtëm konfirmon se IAL Albanian University ka një dokumentacion relativisht të pasur marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit në shërbim të rritjes së cilësisë dhe ndërkombëtarizimit të institucionit.</p> <p>Rezulton gjithashtu se institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi edhe me struktura shtetërore në Tiranë dhe në rrethe për zhvillimin e praktikave mësimore në shkolla qendra dhe organizata të ndryshme. Po ashtu numri i institucioneve në dispozicion të studentëve të programit MSc në Mësuesi për Arsimin Fillor është i madh. Në planin e bashkëpunimit kombëtar, ndërkombëtar dhe atë publik mund të thuhet që AU ka bërë përpjekje dhe punë të kënaqshme në bashkëpunim.</p> <p>Mendojmë se në të ardhmen duhet të rrite më shumë mobilitete e pedagogëve dhe studentëve në kuadrin e projekteve të ndryshme ku institucioni duhet të jetë pjesëmarrës</p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT.

Msc Mësuesi në Arsimin fillor, AU

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës **SWOT** (**S**trengths-pikat e forta, **W**eaknesses- pikat e dobëta, **O**pportunities-mundësitë, **T**hreats-pengesat).

Me cilësinë e anëtarëve të grupit të VJ, konstatojmë që përgjithësisht ka përputhje të RVB me identifikimet që u bënë nga ekspertët e VJ

a. Pika të forta:

- 1) Infrastruktura, mjediset fizike, dhe logjistika në funksion të programit. Numri i vogel i studentëve potencon cilësi në mësimdhënënie dhe në udhëheqjen dhe ndjekjen e studentëve përgjatë përmbushjes së objektivave të programit.
- 2) Staf i PAK është rekrutuar nga institucione prestigjioze. Disa prej tyre janë titullarë në fushat që mbulojnë. Ky fakt më konfirmon seriozitetin e institucionit dhe relativisht garantim të programit.

- 3) Numri i studentëve që ndjekin aktualisht programin në fjalë është i vogël (8 studentë) që e mundëson seriozitetin dhe punë individuale të secilit.
- 4) Sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon relativisht mirë, në menyrë frekvente.

b. Pika të dobëta:

- 1) Staf i akademik {PAE} rezulton të jetë i mirëkualifikuar, por, relativisht i paqëndrueshëm. Në vitin e parë të programit në fjalë, viti akademik 2015-2016, dy prej {PAE} respektivisht ish z/Rektorja, {që mbulonte tri disiplina të rëndësishme në program} dhe një pedagog tjetër, kanë ndërprere kontratat e punës për arsye individuale. Ky fakt, i përcjell institucionit, dhe për pasojë, programit, pasiguri dhe pamundësi për të identifikuar dhe kontraktuar kapacitete të tjera në cilësinë e duhur dhe në kohën e duhur. Institucioni ka tentuar ti mbulojë me kapacitete të reja brenda institucionit, persona të cilët janë të kontraktuara për të mbuluar procese të tjera, të cilët ndërkohë duhet të mbulojnë “vakumin” që krijon largimi i stafit. Ky fakt mundet që e prek cilësinë dhe vijueshmërinë e programit.
- 2) Pese lëndë që zhvillohen në Programin Master në Arsimin Fillor rezultojnë që zhvillohen dhe në bachelor, megjithëse mundet të jene në nivel më të lartë.
- 3) Cilësia e studentëve të rregjistruar në program lë për të dëshiruar. Nota mesatare hyrëse, niveli pothuajse i ulët i gjuhës së huaj, institucionet ku studentët janë të punësuar, nuk përcjellin garancinë se disa prej tyre do të mund të thellohen në studime të metejme doktoare, dhe nuk ofrojnë besimin se mund të kryejnë procese kërkimore.
- 4) Mungesa e titujve literal, {manuale} të konfirmuara në shkencat e edukimit, që do të ishin një bazë teorike për të bërë hulumtime në problematikat që prodhon e përditëshmja shkollore.

c. Mundësitë:

- 1) Në Universitetin shtetëror të Tiranës nuk ka një mastër të tillë të mirëfilltë gjë që e favorizon institucionin që me një studim të detajuar dhe të qëllimtë të tregut dhe një ri-formatim në planin mësimor të sigurojë vazhdimsi të tij.

d. Pengesat:

- 1) Ka një master profesional në Didaktikë, me objektiva dhe synime të përafërta gjë e cila vë në pikpyetje rregjistrimin e studentëve në këtë mastër shkencor
- 2) *Në ligjin e Arsimin të lartë nuk parashikohet Mastër Shkencor si detyrim për licensimin e mesuesve të Arsimin Fillor sic ishte deri tani, ndaj nuk ofron shumë mundësi punësimi për tregun e punës, gje e cila e bën të pasigurtë vazhdimësinë e këtij programi studimi. Fakti i mosrregjistrimeve të asnjë studenti për vitin akademik 2016-2017 e konfirmon këtë.*

Në cilësinë e ekspertëve të jashtëm të grupit, theksojmë se Vendimi për të celur “Master shkencor” në Arsimin Fillor” dëshmon vullnetin dhe predispozitën e institucionit për tu angazhuar në studime të nivelit të dytë të thelluara që cojnë tek kërkimi dhe identifikimi i dukurive në arsimin fillor. Ky vullnet është tërësisht i përligjur, në kushtet kur, shkolla si institucion, po funksionon në rrethana të reja. Sfidat e shkollës, të mesuesve, po shtohen po bëhen më të sofistikuar. *Nevoja për të “identifikuar” situatat “paradoksale” dhe “risitë” në proceset e edukimit, për të “provokuar” mendim të qartë në segmente të edukimit, të con tek nevoja për të diplomuar mësues që do të marrin statusin e*